

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

# INDEKSI I TRANSPARENCËS

TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

2024



# INDEKSI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE I NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE (NJVV)

## Përmbajtja

Hyrje .....	3
Metodologjia.....	5
Indeksi i Transparencës Proaktive të Bashkive.....	9
Indeksi i Transparencës Proaktive të 12 Këshillave të Qarqeve.....	13
Gjetjet e “Indeksit të Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” .....	15

## Hyrje


E drejta për informim, si një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 23 të saj, synon të garantojë kontrollin dhe mbikëqyrjen e qeverisjes nga qytetarët, si një nga mekanizmat kryesore të funksionimit të një shoqërie demokratike. Ligji nr. 119/20214 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “*LDI*”), në harmoni me kuadrin rregullator në fuqi, është instrumenti kryesor për ushtrimin në praktikë të kësaj të drejte individuale.

Për të pestin vit me rradhë, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “*Zyra e Komisionerit*”) ka realizuar monitorimin e transparencës proaktive të bashkive dhe këshillave të qarqeve.

Bazuar në *LDI*, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka dalë me Urdhrin nr. 211/2018 “*Për miratimin e Programit model të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore*”, i cili është i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha bashkitë e vendit. Ky Program i dedikuar i Transparencës (në vijim “*PT*”) është hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 7 të *LDI*, duke u përshtatur me specifikën e veprimtarisë së *NjVV*, funksionet që ushtrojnë dhe shërbimet që ato ofrojnë. Po ashtu, *PT* është në përputhje edhe me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe me ligjin nr. 8548/1999 “Për ratifikimin e “Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”. Ndërsa, *KQ* e përmbushin detyrimin e transparencës proaktive sipas Urdhrit nr. 187/2020 “*Për miratimin e Programit të Transparencës së rishikuar*”, i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit është institucioni i vetëm përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të *LDI* dhe si e tillë, monitoron në vazhdimësi *PT*, për të siguruar në mënyrë konstante transparencën në nivel vendor. *NjVV*, nga ana tjetër, mbartin detyrimin që të publikojnë dhe përditësojnë informacionin/dokumentacionin që prodhojnë në ushtrim të kompetencave ligjore.

Sigurimi i një niveli të lartë të transparencës, në të cilën përfshihet edhe ajo proaktive, arrihet si rezultat i një vetëdije maksimale, kulture përgjegjshmërie dhe etike nga nëpunësit e këtyre autoriteteve publike. Mungesa e tyre ndikon drejtpërdrejtë në uljen e besimit të qytetarëve për mirëqeverisjen e *NjVV*, në parandalimin e korrupsionit, ashtu si edhe në mospjesëmarrje në procesin vendimmarrës.



Zyra e Komisionerit gjatë muajit dhjetor të vitit 2024 monitoroi *PT* në faqet zyrtare në internet të 61 bashkive dhe 12 këshillave të qarqeve. Programi i Transparencës ka qëllim parësor garantimin e njohjes maksimale të publikut me informacionin/dokumentacionin me karakter publik, si dhe të pakësimit të numrit të kërkesave individuale. Ky proces monitorues është bazuar mbi një praktikë të konsoliduar të Zyrës së Komisionerit, e cila është pasuruar edhe me elementë të rinj. “*Indeksi i transparencës proaktive të njërive të vetëqeverisjes vendore*” është një dokument shumë i rëndësishëm i vlerësuar dhe i cituar rregullisht nga raporte të ndryshme të organizatave të shoqërisë civile, që monitorojnë veprimtarinë e këtyre autoriteteve publike.

Për Zyrën e Komisionerit përveçse kjo veprimtari përbën përmbushje të detyrave të saj institucionale në monitorimin e zbatimit të detyrimeve ligjore për miratimin, publikimin dhe përditësimin e *PT* nga bashkitë dhe këshillat e qarqeve, synon që të konsolidojë këtë traditë të analizës krahasuese të nivelit të transparencës proaktive të tyre. Në rubrikat e dedikuara të Programit të Transparencës, i cili publikohet në faqen zyrtare apo në mjediset e institucionit, çdo autoritet publik duhet të vendosë në dispozicion të qytetarëve informacionin/dokumentacionin me karakter publik në formatet më të aksesueshme dhe mënyrat më të qarta. Ky proces kërkon përkushtim, vëmendje dhe profesionalizëm, duke qenë se pikëzimi nga monitorimi i Zyrës së Komisionerit përcakton dhe kategorizimin e bashkive dhe këshillave të qarqeve në renditjen përfundimtare në “*Indeksin e transparencës*”.




## Metodologjia

Sistemi i matjes i përdorur në këtë monitorim i referohet 12 treguesve kryesorë, të cilët bëjnë vlerësimin objektiv të nivelit funksional të transparencës proaktive të njërive të vetëqeverisjes vendore. Numri total i pikëve të vlerësimit të treguesve është 12 (dymbëdhjetë). Bazuar në pikëzimin e çdo treguesi llogaritet shuma totale e vlerësimit për secilën bashki dhe këshill qarku.

Instrumenti kryesor për matjen e transparencës proaktive është publikimi i Programit model të Transparencës në faqen zyrtare të *NjVV*. Sistemi i matjes i përdorur në këtë metodologji është i thjeshtë dhe lejon një vlerësim të shpejtë të treguesve bazuar në gjendjen reale të tyre në momentin e kërkimit në faqen zyrtare të internetit, duke krijuar mundësinë e procesimit të menjëhershëm për shkak të lehtësisë së përdorimit dhe shpejtësisë, në arritjen e përfundimeve në lidhje me përcaktimin e nivelit të transparencës.

Ky sistem me 12 tregues ka si qëllim matjen dhe raportimin periodik të transparencës për secilën bashki/këshill qarku dhe i shërben Zyrës së Komisionerit si bazë për të monitoruar nivelin funksional të saj për evidentimin e progresit, pikat e dobëta dhe të forta të tij. Njëkohësisht, ky pikëzim i referohet dhe është i ngjashëm me sistemin e matjes së transparencës së *NjVV* i përdorur dhe në vitet parardhëse, të cilat i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit në lidhjen: <https://idp.al/raporte-monitorimi/>.

“*Indeksi i transparencës*” për vitin 2024 ka një përmirësim në krahasim me atë të një viti më parë, përse i përket sasisë së të dhënave të përfshira në të. Në këtë dokument janë marrë në analizë 12 kategori informacioni përkundrejt 10 të tillave të listuara në “*Indeksin*” e vitit 2023. Sistemi i matjes së treguesve vazhdon të jetë i njëjti si ai i periudhës paraardhëse, ndërkohë, që përlllogaritja e treguesve është vendosur të kryhet me 3 nivele:

-  **0** pikë në rast se informacioni nuk është publikuar;
-  **0,5** pikë kur informacioni është publikuar pjesërisht dhe
-  **1** pikë kur informacioni është i publikuar plotësisht.

Më poshtë gjenden të listuara të dymbëdhjetë treguesit e analizuar të 61 njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ata për 12 këshillat e qarqeve.

**Tabela 1. Treguesit e monitorimit të bashkive**

<b>Treguesi i parë:</b>	<i>Publikimi i Programit model të Transparencës për autoritetin publik</i>	<b>Treguesi i shtatë:</b>	<i>Publikimi i raporteve të auditimit të KLSH</i>
<b>Treguesi i dytë:</b>	<i>Publikimi i strukturës së bashkisë</i>	<b>Treguesi i tetë:</b>	<i>Publikimi i PBA 2024-2026</i>
<b>Treguesi i tretë:</b>	<i>Publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak</i>	<b>Treguesi i nëntë:</b>	<i>Publikimi i Paketës Fiskale 2024</i>
<b>Treguesi i katërt:</b>	<i>Publikimi i CV së titullarit të autoritetit publik</i>	<b>Treguesi i dhjetë<sup>1</sup>:</b>	<i>Publikimi i Regjistri të Kërkesave dhe Përgjigjeve i përditësuar gjatë vitit 2024, sipas urdhrin nr. 188/2020 “Për miratimin e regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar”</i>
<b>Treguesi i pestë:</b>	<i>Publikimi i legjislacionit</i>	<b>Treguesi i njëmbëdhjetë:</b>	<i>Publikimi i shërbimeve në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike</i>
<b>Treguesi i gjashtë:</b>	<i>Publikimi i të dhënave të koordinatorit për të drejtën e informimit,</i>	<b>Treguesi i dymbëdhjetë:</b>	<i>Publikimi i informacionit mbi “Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik”</i>

Ndërkaq, për monitorimin e *këshillave të qarqeve* janë përcaktuar 12 indikatorë të tjerë në përputhje me detyrimin e transparencës proaktive sipas Urdhrit nr. 187/2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës së rishikuar”, i ndryshuar.

<sup>1</sup>Do të shënohen me \*“Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve” përcjellë me e-mail pranë Zyrës së Komisionerit


**Tabela 2. Treguesit e monitorimit të këshillave të qarqeve**

<b>Treguesi i parë:</b>	<i>Publikimi i Programit model të Transparencës për autoritetin publik</i>	<b>Treguesi i shtatë:</b>	<i>Publikimi i raporteve të monitormit/auditimit</i>
<b>Treguesi i dytë:</b>	<i>Publikimi i strukturës</i>	<b>Treguesi i tetë:</b>	<i>Buxheti 2024</i>
<b>Treguesi i tretë:</b>	<i>Funksionet dhe detyrate e AP</i>	<b>Treguesi i nëntë:</b>	<i>Regjistri i parashikimit të prokurimit publik 2024</i>
<b>Treguesi i katërt:</b>	<i>Publikimi i CV së titullarit të autoritetit publik</i>	<b>Treguesi i dhjetë<sup>2</sup>:</b>	<i>Publikimi i Regjistri të Kërkesave dhe Përgjigjeve i përditësuar gjatë vitit 2024, sipas urdhrin nr. 188/2020 “Për miratimin e regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar”</i>
<b>Treguesi i pestë:</b>	<i>Publikimi i legjislacionit</i>	<b>Treguesi njëmbëdhjetë</b>	<i>Lista e shërbimeve që ofron AP</i>
<b>Treguesi i gjashtë:</b>	<i>Publikimi i të dhënave të koordinators për të drejtën e informimit</i>	<b>Treguesi dymbëdhjetë:</b>	<i>Lista dokumenteve që administrohen nga AP me afatet e ruajtje</i>

Pas monitorimit të çdo bashkie dhe këshilli qarku për 12 kategoritë e mësipërme, numri i pikëve u mbledh për secilën prej tyre dhe hartua renditja në “Indeks” duke filluar nga autoriteti publik i cili ka grumbulluar më shumë pikë, duke zbritur deri tek autoriteti publik me numrin më të ulët të tyre.

<sup>2</sup>Do të shënohen me \*“Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve” përcjellë me e-mail pranë Zyrës së Komisionerit.

Për të evidentuar më mirë qasjen ndaj transparencës proaktive të njësive të vetëqeverisjes vendore, Zyra e Komisionerit për të katërtin vit radhazi paraqet sistemin e matjes të transparencës proaktive nëpërmjet një sistemi semafor.



Autoritetet publike që i kanë të gjithë treguesit negativ dhe për këtë arsye kanë grumbulluar **0-3** pikë kanë një transparencë proaktive të pamjaftueshme dhe në semafor shënohen me dritë të kuqe.

Autoritetet publike që kanë grumbulluar **3.5-6** pikë kanë një transparencë proaktive të ulët dhe në semafor janë shënuar me dritë të verdhë.

Autoritetet publike që kanë grumbulluar **6.5-9.5** pikë kanë një transparencë proaktive mesatare dhe në semafor janë shënuar me dritë të bardhë.

Autoritetet Publike që i kanë të gjithë apo shumicën e treguesve pozitiv dhe kanë grumbulluar **10-12** pikë kanë një transparencë proaktive të lartë dhe në semafor janë shënuar me dritë të gjelbër.

Rezultatet e këtij monitorimi dhe publikimi vjetor i këtij dokumenti nxit njësitë e vetëqeverisjes vendore që të angazhohen në mënyrë konstante për të rritur nivelin e transparencës, por, gjithashtu, ato shërbejnë edhe si një indikator për Zyrën e Komisionerit në procesin vendimmarrës për rastet e mosrespektimit dhe mospërbushjes së dispozitave të *LDI*.



## Indeksi i Transparencës Proaktive të Bashkive

Zyra e Komisionerit monitoroi në muajin dhjetor të vitit 2024 faqet zyrtare të 61 bashkive.

Renditja e autoriteteve publike me të njëjtin numër pikësh është sipas rendit alfabetik.

### Indeksi për 61 bashkitë

Autoriteti Publik	Program Transparence	Struktura e AP	Vendimet e Këshillit Bashkiak 2024	Cvetullarit	Legjislacion	Kordinatori për të Drejtën e Informimit	Raportet monitorimi/auditimi KLSH	PBA Final 2024-2026	Paketa Fiskale 2024	Regjistrimi i kërkesave dhe përgjigjeve 2024	Shërbime në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike	Kordinatori për konsultimin me publikun	Total
Bashkia Belsh	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
Bashkia Bulqizë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
Bashkia Dropull	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
Bashkia Klos	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
Bashkia Korçë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
Bashkia Lezhë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
Bashkia Mirditë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
Bashkia Kukës	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0.5	1	1	11.5
Bashkia Roskovec	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0.5	1	1	11.5
Bashkia Skrapar	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0.5	1	1	11.5
Bashkia Dibër	1	1	1	0	1	1	1	1	1	1	1	1	11
Bashkia Kolonjë	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1	1	11

Bashkia Mallakastër	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	1	1	11
Bashkia Mat	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	11
Bashkia Përmet	1	1	1	1	0.5	1	1	1	1	0.5	1	1	11
Bashkia Tiranë	1	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	11
Bashkia Shijak	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1*	1	1	11*
Bashkia Devoll	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0.5	1	0	10.5
Bashkia Lushnje	1	1	1	1	1	1	0	1	1	0.5	1	1	10.5
Bashkia Pogradec	1	1	1	1	1	1	0	1	1	0.5	1	1	10.5
Bashkia Prrenjas	1	1	0	1	1	1	1	1	1	0.5	1	1	10.5
Bashkia Shkodër	1	1	1	1	0.5	1	0	1	1	1	1	1	10.5
Bashkia Kurbin	1	1	<u>1</u>	1	1	1	0	1	1	1	0	1	10
Bashkia Patos	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1	0	1	10
Bashkia Rrogozhinë	1	1	1	1	1	1	0	0	1	1	1	1	10
Bashkia Selenicë	1	1	1	0	1	1	1	0	1	1*	1	1	10
Bashkia Malësi e Madhe	0.5	1	1	1	1	1	0	1	0	1	1	1	9.5
Bashkia Peqin	1	1	1	0	1	0.5	1	1	0	1	1	1	9.5
Bashkia Berat	1	1	<u>1</u>	1	1	1	0	0	0	1	1	1	9
Bashkia Elbasan	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1	0	0	9
Bashkia Kamëz	1	1	1	1	1	1	0	0	0	1	1	1	9
Bashkia Poliçan	1	1	1	1	1	1	0	0	1	1	0	1	9
Bashkia Vau i Dejës	1	1	1	1	1	1	0	0	1	1	1	0	9
Bashkia Sarandë	1	1	1	1	1	1	1	0	1	1*	1	0	9*
Bashkia Fier	1	1	1	1	0	1	0	1	0.5	1	0	1	8.5

Bashkia Finiq	1	0.5	1	0	1	1	1	0	0.5	0.5	1	1	8.5
Bashkia Himarë	1	1	1	1	0.5	1	0	0.5	0	1	0.5	1	8.5
Bashkia Vlorë	1	1	1	1	0.5	1	0	0	0	1	1	1	8.5
Bashkia Memaliaj	1	1	1	0	1	0.5	1	0	0	0.5	1	1	8
Bashkia Cërrik	1	0.5	1	1	1	1	1	0	0	0.5	0.5	0	7.5
Bashkia Gramsh	1	0.5	1	1	1	1	0	0	0	0.5	0.5	1	7.5
Bashkia Has	1	1	1	1	0.5	1	0.5	0	0	0.5	0	1	7.5
Bashkia Kuçovë	1	1	1	0	1	1	0	0	1	0.5	0	1	7.5
Bashkia Durrës	1	1	1	1	1	1	0	0	0	1	0	0	7
Bashkia Librazhd	0.5	1	1	1	1	1	0	1	0	0.5	0	0	7
Bashkia Delvinë	1	0.5	1	0	1	1	1	0	0.5	0.5*	0.5	0	7*
Bashkia Pukë	1	1	0	1	1	1	0	0	0	1	0.5	0	6.5
Bashkia Vorë	1	1	1	1	1	1	0	0	0	0.5	0	0	6.5
Bashkia Konispol	1	1	1	1	1	1*	0	0		0.5*	0	0	6.5*
Bashkia Pustec	1	0	1	0	1	1	1	0	1	0.5*	0	0	6.5*
Bashkia Tropojë	1	1	1	0	1	1	0	0	0	1	0	0	6
Bashkia Maliq	1	0	1	1	1	1	0	0	0	0.5	0	0	5.5
Bashkia Gjirokastër	0.5	0.5	0	0	1	1	0	1	0	1*	0.5	0	5.5
Bashkia Divjakë	1	0	1	0	1	1	0	1	0	1*	0	0	5*
Bashkia Dimal	1	0	0	1	1	1	0	0	0	0.5	0	0	4.5
Bashkia Këlcyrë	1	1	0	0	1	1	0	0	0	0.5*	0	0	4.5*
Bashkia Libohovë	1	0	0	1	1	1	0	0	0	0.5*	0	0	4.5*

Bashkia Tepelenë	1	0	1	0	1	1*	0	0	0	0.5*	0	0	4.5*
Bashkia Krujë	0.5	0	0.5	1	1	1	0	0	0	0	0	0	4
Bashkia Fushë-Arrëz	0	0	1	0	0	1*	0	0	1	1	0	0	4*
Bashkia Kavajë	1	0	0	1	0	1*	0	0	0	1*	0	0	4*

## Indeksi i Transparencës Proaktive të 12 Këshillave të Qarqeve

Zyra e Komisionerit monitoroi në muajin dhjetor të vitit 2024 faqet zyrtare të 12 këshillave të qarqeve.


Renditja e autoriteteve publike me të njëjtin numër pikësh është sipas rendit alfabetik.

Autoriteti Publik	Program Transparence	Struktura e AP	Funksionet dhe detyrat e AP	Cvetullarit	Legjislacion	Kordinatori për të Drejtën e Informimit	Raporte monitorimi/auditimi	Buxheti 2024	Regjistri i parashikimit të prokurimit publik 2024	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve 2024	Lista e shërbimeve që ofron AP	Lista dokumenteve që administrohen nga AP me afatet e ruajtjes	Total
Këshilli i Qarkut Shkodër	1	1	1	1	1	1	0	1	1	1*	1	1	11*
Këshilli i Qarkut Elbasan	1	1	1	1	0.5	1	1*	1	1	1	0	1	10.5*
Këshilli i Qarkut Fier	1	1	1	1	1	1	0	1	0	0	1	1	10
Këshilli i Qarkut Berat	1	1	1	1	1	1	0	1	0	1	1	1	10
Këshilli i Qarkut Kukës	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0.5	0	0	9.5

Këshilli i Qarkut Durrës	1	1	1	0	1	1	1*	0	1	0.5	1	0.5	9*
Këshilli i Qarkut Vlorë	1	1	1	1	1	1	0	0	1	1*	1	0	9*
Këshilli i Qarkut Tiranë	1	1	0.5	1	1	1	0	0	0	1*	1	0	8.5*
Këshilli i Qarkut Korçë	1	1	1	0	1	1	0	0	0	1*	1	1	8*
Këshilli i Qarkut Dibër	1	1	0	1	1	1	0	0	0	1	1	0	7
Këshilli i Qarkut Gjirokastër	1	1	0	0	0	1	0	0	1	1	0	1	6
Këshilli i Qarkut Lezhë	0.5	1	0	0	1	1	0	0	0	0.5*	1	0	5*

## Gjetjet e “Indeksit të Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”

Në përfundim të monitorimit të kryer rezultojnë se:



**30** njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë proaktive të lartë” (semafor i gjelbër) ose 41%.

**30** njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë proaktive mesatare” (semafor i bardhë) ose 41%.

**13** njësi të vetëqeverisjes vendore kanë “Transparencë proaktive të ulët” (semafor i verdhë) ose 18%.

**0** njësi e vetëqeverisjes vendore ka transparencë proaktive të pamjaftueshme (semafor i kuq) ose 0%.

Zyra e Komisionerit konstaton se nga krahasimi i gjetjeve për vitin 2024 me ato të vitit 2023, kemi një përmirësim të transparencës te njësitë e vetëqeverisjes vendore nga tërësia e vlerësimit të procesit monitorues. Për shkak të shtimit të numrit të treguesve matës dhe mënyrës së gjykimit të informacionit/dokumentacionit të publikuar nga *NjVV*, institucioni thekson faktin se janë bërë dukshëm hapa përpara në këtë drejtim, por ka ende shumë punë për të bërë. Kështu kemi rritje të numrit të *AP* të kategorizuara me ngjyrë të gjelbër nga 21 në 30 (+9 *autoritete publike*), si shprehje e një përkushtimi konstant të tyre ndaj transparencës dhe ndërveprimit me publikun. Në kategorinë e “Transparencë proaktive mesatare” konstatohet një ulje të numrit të *AP*, që tregon për ndryshimin më të madh në raport me vitin 2023, nga 43 në 30 (-13 *autoritete publike*). Në kategorinë e “Transparencës proaktive të ulët” konstatohet një përkeqësim në raport me një vit më parë nga 6 në 13 (+7 *autoritete publike*), por kemi një përmirësim të dukshëm në kategorinë e “Transparencës proaktive të pamjaftueshme” nga 3 në 0 (-3 *autoritete publike*). Për Zyrën e Komisionerit ky ushtrim i përvitshëm tregon edhe një herë se roli monitorues dhe mikëqyrës i saj për konsolidimin e transparencës proaktive të këtyre autoriteteve publike ka sjellë rezultate konkrete, por duhet thelluar ndërveprimi i të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces: *AP*, qytetarë, organizata të shoqërisë civile dhe media, për kthimin e saj në normë.